

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare
“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN
E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”
24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri

Akil Ukaj¹,
Egerta Terziu²
Arlind Hoxhaj³

TREGU I SIGURIMEVE

Abstrakt

Tregu i sigurimeve është një pjesë shumë e rëndësishme e sistemit financiar.

Në të përfshihen shoqëritë private dhe shtetërore të cilat realizojnë procesin e sigurimeve të individëve ose bizneseve. Për të përfituar nga ky shërbim, individët dhe bizneset paguajnë prime sigurimi për t’u mbrojtur nga një ngjarje specifike dhe në rast të ndodhjes së ngjarjes, përfitojnë një shumë të caktuar që në fillim nga kontrata me shoqërinë e sigurimit.

Sigurimi i Jetës, i ofrohet individëve dhe në rast të humbjes së jetës, një individ tjetër, i përcaktuar nga i siguruari, përfiton një shumë sipas kontratës.

Sigurimi i Jo-Jetës përfshin gjithë shërbimet e sigurimit të cilat nuk përfshihen në sigurimin e Jetës (si sigurimi i pasurive të paluajtshme, sigurimi i shëndetit, sigurimi i automjeteve, etj.)

Gjithashtu duhet të përmendim se tregu i sigurimeve është shumë i rëndësishëm, sepse lejon kalimin e rreziqeve nga një palë tek një tjetër. Pra, individët dhe bizneset që nuk duan të mbajnë rrezik, mund t’ia kalojnë atë një shoqërie sigurimi. Dhe ky është një funksion thelbësor për funksionimin e mirë të një tregu ekonomik dhe financiar në një vend.

Fjalë kyçe: *Tregu i Sigurimeve, përfituesit, të ardhurat, shoqëritë private, prim sigurimi, kontratë, sigurimi i shëndetit.*

¹ Viti i I-rë Menaxhim Biznesi “ALBANIAN UNIVERSITY akil_uka@yahoo.com, 0685489662

² Viti i I-rë Menaxhim Biznesi “ALBANIAN UNIVERSITY egertat@gmail.com, 0685507944

³ Viti i I-rë Menaxhim Biznesi “ALBANIAN UNIVERSITY arihoxha755@gmail.com, 0682796183